



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT

Nr. 1367 Prot.

Tiranë, më 27 04 .2026

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 3679/1 PROT., DATË 16.01.2026 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI ALEKSANDËR VARFAJ”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Aleksandër Varfaj me nr. 3281 prot., datë 24.11.2023, nr. 3281/2 prot., datë 06.12.2023 dhe nr. 3281/3 prot., datë 06.12.2024, në të cilën ngrihen pretendime për veprimtarinë e magjistratit O.Rr., me detyrë prokuror në prokurorinë pranë Gjykatën së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, si dhe magjistratit M.O., gjyqtar në po këtë gjykatë, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 3679/1 prot., datë 16.01.2026, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Aleksandër Varfaj”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr/ 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e saj. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga: Don Bosko”, nr. 1, Autoservis BMW;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

